



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “**RIKUALIFIKIM URBAN I QËNDRËS SË FSHATIT
ÇORRAJ**”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45210000-2,
Punime ndërtimi.**

VLERA E FONDIT: **7 376 189** (shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e
tetëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;
- NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
- NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-18 A – Punime topogjeodezike.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Bazuar në natyrën e punimeve të parashikuara në preventive, rezulton se licencat e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe volumet e punimeve që do të realizohen.

Kategoria NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë

Kjo kategori licence justifikohet nga fakti se objekti përfshin punime të konsiderueshme të gjurmimit të dheut dhe përgatitjes së trupit të rrugës apo të infrastrukturës mbështetëse. Punimet e gjurmimit janë proces bazë për realizimin e shtresave të mëvonshme konstruktive, si shtresa e çakëllit, shtresa stabilizante dhe shtresat e konglomeratit dhe betonit.

Kategoria NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me realizimin e shtresave rrugore dhe elementëve të infrastrukturës së qarkullimit. Në preventiv janë parashikuar punime tipike të infrastrukturës rrugore, si shtresë çakëlli, shtresë graniti, shtresë konglomerati, shtresë stabilizanti, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil, shtresa betoni dhe shtrim me pllaka guri natyral. Këto janë punime karakteristike të ndërtimit dhe rehabilitimit të rrugëve, trotuareve, shesheve dhe infrastrukturës urbane, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të licencës NP-4 A.

Kategoria NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit konsiderohet teknikisht e justifikuar në raport me zërat konkretë të preventivit, pasi punimet e parashikuara ndikojnë drejtpërdrejt në sistemimin, stabilizimin dhe funksionalitetin mjedisor të infrastrukturës që do të realizohet.

Konkretisht, zërat gjurmim dheut, shtresë çakëlli, shtresë graniti, shtresë konglomerati, shtresë stabilizanti, shtresë betoni, mur b/arme, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil dhe shtresë me pllaka guri natyral janë punime që lidhen jo vetëm me ndërtimin e infrastrukturës, por edhe me sistemimin e terrenit, disiplinimin e ujërave sipërfaqësore, mbrojtjen nga erozioni, stabilizimin e trupit të rrugës dhe të shtresave mbajtëse, rehabilitimin dhe përmirësimin e kushteve mjedisore urbane dhe infrastrukture.

Punimet e shtresave rrugore dhe të stabilizantit ndikojnë drejtpërdrejt në kontrollin e infiltrimeve, shmangien e degradimit të terrenit dhe garantimin e qëndrueshmërisë së strukturës në raport me faktorët mjedisorë dhe hidrologjikë.

Gjithashtu, realizimi i mureve b/arme, shtresave betonike, sistemimeve me pllaka guri natyral lidhet me mbrojtjen e infrastrukturës nga rrëshqitjet, amortizimi i terrenit dhe degradimi mjedisor, duke përbërë elementë të inxhinierisë së mjedisit dhe sistemit urban.

Në këtë kuptim, licenca NP-12 A garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike, eksperiencën profesionale dhe standardet e nevojshme për realizimin e punimeve që kanë ndikim në mbrojtjen dhe administrimin e elementëve mjedisorë të objektit.

Kategoria NS-18 A – Punime topogjeodezike

Kjo kategori licence lidhet me nevojën për piketim, matje topografike, rlevime dhe kontroll kuotash dhe aksesh. Duke qenë se punimet përfshijnë shtresa infrastrukturore, mure b/a dhe sistemime me nivele teknike të përcaktuara, realizimi korrekt i tyre kërkon shërbime topogjeodezike gjatë zbatimit. Për rrjedhojë, kërkesa për licencën NS-18 A është teknikisht e justifikuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë

se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;
- 1 (një) inxhinier mjedisi;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikave 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 82 të LPP-së.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruara, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë

elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor drejtues teknik lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, si gërmim dheu, shtresa çakëlli, shtresa graniti, shtresa konglomerati, shtresa stabilizanti, shtresa betoni, mur b/arme, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil dhe shtresë me pllaka guri natyral, si dhe me kategoritë e licencës së kërkuar për zbatimin e punimeve objekt kontrate.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi është teknikisht e nevojshme pasi punimet e parashikuara lidhen me realizimin e shtresave konstruktive, punimeve të betonit, murit b/arme dhe shtresave rrugore, të cilat përfshihen në kategoritë e licencës NP-1 A “Punime gërmimi në tokë” dhe NP-4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale”. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për drejtimin teknik të punimeve, kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e projektit sipas specifikimeve teknike.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet lidhet drejtpërdrejt me kategorinë NS-18 A “Punime topogjeodezike”, pasi punimet objekt kontrate kërkojnë piketime, rlevime topografike, kontroll kuotash dhe nivelesh, përcaktim aksesh dhe volume gërmimi për realizimin korrekt të shtresave infrastrukturore, sistemimeve dhe elementëve ndërtimorë. Për shkak të natyrës së punimeve infrastrukturore dhe të gërmimeve, prania e këtij specialisti është e domosdoshme për garantimin e saktësisë teknike të zbatimit.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier mjedisi është në përputhje me kategorinë e licencës NP-12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”, pasi punimet e parashikuara ndikojnë në sistemin e terrenit, stabilizimin e sipërfaqeve, administrimin e materialeve inerte dhe kontrollin e ndikimeve

mjedisore gjatë procesit të ndërtimit. Punime si gërmimet, shtresat stabilizuese, asfaltobetoni, betonimet dhe sistemimet sipërfaqësore kërkojnë mbikëqyrje teknike edhe nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të ndikimeve që krijohen gjatë zbatimit të kontratës.

Për rrjedhojë, kërkesa për personelin teknik të sipërcituar është në përputhje me natyrën e punimeve të preventivit dhe kategoritë e licencave të kërkuara, konkretisht NP-1 A, NP-4 A, NP-12 A dhe NS-18 A, dhe është proporcionalisht e lidhur me objektin e prokurimit dhe e nevojshme për realizimin korrekt të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë:

- 2 (dy) betonues;
- 1 (një) pllakashtrues;
- 1 (një) shtrues asfalti;
- 1 (një) elektrikist;
- 1 (një) teknik ndërtimi;
- 1 (një) manovrator.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin,

personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për disponimin e punonjësve të specializuar dhe të kualifikuar lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe proceset teknologjike të punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht gërmim dheu, shtresa çakëlli, shtresa graniti, shtresa konglomerati, shtresa stabilizanti, shtresa betoni, mur b/arme, shtresë asfaltobetoni me granil, shtresë binderi me granil dhe shtresë me pllaka guri natyral.

Kërkesa për 2 (dy) betonues është teknikisht e nevojshme pasi objekti përfshin punime me beton dhe betonarme, si realizimi i shtresave të betonit dhe murit b/arme. Proceset e përgatitjes, hedhjes, nivelimit dhe trajtimit të betonit kërkojnë punonjës të specializuar për garantimin e cilësisë, rezistencës dhe zbatimit korrekt sipas parametrave teknikë të projektit.

Kërkesa për 1 (një) pllakashtrues lidhet drejtpërdrejt me realizimin e shtresës me pllaka guri natyral, e cila kërkon njohuri dhe aftësi profesionale për vendosjen, nivelimin, prerjen dhe sistemin korrekt të pllakave, në mënyrë që të garantohet cilësia funksionale dhe estetike e sipërfaqeve të trajtuara.

Kërkesa për 1 (një) shtrues asfalti është e argumentuar teknikisht pasi preventivi përfshin shtresë asfaltobetoni me granil dhe shtresë binderi me granil, punime të cilat kërkojnë procese të specializuara të shtrimit, nivelimit dhe kompaktimit të asfaltit, në përputhje me specifikimet teknike dhe parametrat e infrastrukturës rrugore.

Kërkesa për 1 (një) elektrikist konsiderohet e nevojshme për shkak se gjatë realizimit të punimeve infrastrukture dhe të kantierit kërkohet menaxhimi dhe mirëmbajtja e instalimeve elektrike provizore, furnizimit të pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit, si dhe garantimi i kushteve teknike dhe të sigurisë gjatë zbatimit të punimeve.

Kërkesa për 1 (një) teknik ndërtimi lidhet me nevojën për ndjekjen e proceseve të zbatimit në terren, kontrollin e volumeve, organizimin e punimeve dhe asistimin teknik gjatë realizimit të shtresave konstruktive, gërmimeve, betonimeve dhe sistemeve infrastrukture. Tekniku i ndërtimit shërben si hallkë koordinuese ndërmjet stafit drejtues teknik dhe zbatimit praktik të punimeve në kantier.

Kërkesa për 1 (një) manovrator është drejtpërdrejt e lidhur me natyrën e punimeve të gërmimit, transportit dhe sistemit të materialeve, si dhe me përdorimin e makinerive të ndërtimit që nevojiten për realizimin e shtresave rrugore, gërmimeve dhe ngjeshjes së materialeve. Kryerja e këtyre proceseve kërkon personel të specializuar dhe të pajisur me kualifikimet përkatëse për operimin e mjeteve dhe makinerive të kantierit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin e fundit, prej minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonësve, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Kërkesa për disponimin e minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësve është teknikisht e argumentuar në raport me volumet e punimeve të parashikuara në preventiv dhe me afatin 5-mujor të realizimit të kontratës, pasi natyra e punimeve kërkon zhvillimin paralel të disa proceseve të punës dhe angazhimit të vazhdueshëm të fuqisë punëtore në kantier.

Konkretisht, për realizimin e punimeve të gërmimit të dheut, ngarkimit, transportit dhe sistemimit të materialeve nevojiten minimalisht 3 punonjës, përfshirë manovratorin dhe punëtorët ndihmës për orientimin, sistemimin dhe mbështetjen e proceseve të gërmimit dhe nivelimit të terrenit.

Për realizimin e shtresave të çakëllit, granitit, konglomeratit dhe stabilizantit nevojiten minimalisht 4 punonjës, të cilët angazhohen në shpërndarjen e materialit, nivelimin, ujitjen dhe kompaktimin

e shtresave rrugore, procese që kërkojnë vazhdimësi dhe realizim sipas parametrave teknikë të projektit.

Për punimet me beton dhe betonarme, përfshirë shtresat e betonit dhe murin b/arme, nevojiten minimalisht 3 punonjës të specializuar, konkretisht betonues dhe punëtorë ndihmës, për proceset e përgatitjes, hedhjes, vibrimit, nivelimit dhe trajtimit të betonit.

Për realizimin e shtresës asfaltbetoni me granil dhe shtresës binder me granil nevojiten minimalisht 2 punonjës të specializuar për shtrimin, nivelimin dhe kontrollin e procesit të asfaltimit, duke marrë në konsideratë zhvillimin e punimeve sipas etapave të zbatimit.

Për realizimin e shtresës me pllaka guri natyral nevojiten minimalisht 2 punonjës, përfshirë pllakashtruesin dhe një punëtor ndihmës, për vendosjen, prerjen, nivelimin dhe sistemimin korrekt të pllakave dekorative dhe funksionale.

Gjithashtu, për ndjekjen dhe koordinimin e punimeve në terren kërkohet minimalisht 1 teknik ndërtimi, i cili koordinon proceset e zbatimit, kontrollon realizimin sipas projektit dhe asiston drejtimin teknik të kantierit.

Në total, realizimi i këtyre proceseve të punës kërkon minimalisht 3 punonjës për gjurmime dhe sisteme, 4 punonjës për shtresa rrugore dhe stabilizante, 3 punonjës për punime betoni dhe betonarme, 2 punonjës për asfaltim, 2 punonjës për shtrim pllakash guri natyral dhe 1 teknik ndërtimi pra gjithsej 15 punonjës.

Ky numër konsiderohet i nevojshëm për të garantuar realizimin paralel të proceseve të punës, përballimin e volumeve të preventivit dhe përfundimin e punimeve brenda afatit 5-mujor të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr. Mjetet/Pajisjet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>1 Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>2 Kamion me vinc</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>3 Kamionçinë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>4 Asfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>5 Rul ngjeshës</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>6 Autobetonierë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>7 Eskavator me zinxhirë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>8 Fadromë me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>9 Betonierë kantieri</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>10 Gjenerator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>11 Kokore mbrojtëse</i>	<i>15 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Për mjetet në pronësi duhet të paraqiten:

a) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;

b) leja e qarkullimit;

c) certifikata e kontrollit teknik;

ç) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqiten:

a) kontrata noteriale e qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;

b) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;

c) leja e qarkullimit;

ç) certifikata e kontrollit teknik;

d) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara si të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqitet certifikata për transport mallrash të rrezikshëm, e lëshuar nga institucionet përkatëse dhe e vlefshme.

Për pajisjet teknike në pronësi duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Kur pajisjet janë marrë me qira, duhet të paraqitet:

- kontrata e qirasë;*
- kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes;*
- dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.*

Për mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar, operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara, duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme si mjeti, ashtu edhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- deklaratë për pranimin e verifikimit të mjeteve dhe pajisjeve nga Autoriteti Kontraktor në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës;*
- deklaratë që mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në procedura të tjera të shpallura fituese;*
- deklaratë mbi vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.*

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për

ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike të përcaktuara është e lidhur me natyrën e punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë gjermim dheu, shtresa çakëlli, shtresa graniti, shtresa konglomerati, shtresa stabilizanti, shtresa betoni, mur b/arme, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil dhe shtresë me pllaka guri natyral, si dhe me afatin 5-mujor të realizimit të punimeve.

Kërkesa për 2 kamionë me kapacitet mbajtës mbi 20ton është e nevojshme për transportin e materialeve inerte, si dheu, çakëlli, graniti, konglomerati, stabilizanti, agregatet për beton dhe materialet asfaltike, duke marrë në konsideratë volumet e konsiderueshme të materialeve që duhet të transportohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë realizimit të punimeve. Disponimi i dy mjeteve të tilla garanton vijimësinë e proceseve të punës dhe respektimin e afatit të kontratës.

Kërkesa për 1 kamion me vinc lidhet me nevojën për ngarkim, shkarkim dhe transport të materialeve, pajisjeve dhe elementëve të ndryshëm të kantierit, veçanërisht gjatë realizimit të punimeve të betonit, sistemimeve dhe furnizimit me materiale të rënda.

Kërkesa për 1 kamionçinë konsiderohet e nevojshme për transportin e personelit teknik, veglave të punës, materialeve ndihmëse dhe koordinimin logjistik të aktivitetit në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Kërkesa për 1 asfaltoshtuese lidhet drejtpërdrejt me realizimin e shtresës asfaltbetoni me granil dhe shtresës binder me granil, pasi këto procese kërkojnë pajisje të specializuara për shtrimin uniform, nivelimin dhe realizimin korrekt të shtresave asfaltike sipas parametrave teknikë të projektit.

Kërkesa për 1 rul ngjeshës është teknikisht e domosdoshme për realizimin e proceseve të kompaktimit të shtresave të çakëllit, granitit, konglomeratit, stabilizantit dhe asfaltit, me qëllim arritjen e densitetit dhe parametrave mbajtës të kërkuar nga specifikimet teknike.

Kërkesa për 2 autobetonierë lidhet me punimet e betonit dhe betonarmesë, konkretisht realizimin e shtresave të betonit dhe murit b/arme. Disponimi i dy autobetonierëve garanton furnizim të vazhdueshëm me beton gjatë proceseve të hedhjes dhe shmang ndërprerjet që mund të cenojnë cilësinë teknike të punimeve.

Kërkesa për 1 eskavator me zinxhirë është drejtpërdrejt e lidhur me punimet e gjermimit të dheut, sistemimit të terrenit dhe ngarkimit të materialeve. Ky mjet është i nevojshëm për realizimin e volumeve të gjermimit dhe përgatitjen e trupit të shtresave infrastrukturore.

Kërkesa për 1 fadromë me goma konsiderohet e nevojshme për shpërndarjen, sistemimin dhe ngarkimin e materialeve inerte gjatë realizimit të shtresave rrugore, betonimeve dhe sistemimeve të ndryshme në kantier.

Kërkesa për 2 betonierë kantieri lidhet me nevojën për përgatitjen e sasive ndihmëse të betonit dhe llaçrave në terren, veçanërisht për punime lokale, sistemime dhe elementë ndërtimorë që kërkojnë prodhim të vazhdueshëm në kantier.

Kërkesa për 1 gjenerator është e argumentuar teknikisht pasi siguron furnizimin me energji elektrike të pajisjeve dhe proceseve të punës në rastet kur mungon furnizimi i qëndrueshëm në kantier, duke garantuar vijimësinë normale të aktivitetit ndërtimor.

Kërkesa për 15 kokore mbrojtëse lidhet drejtpërdrejt me numrin minimal të punonjësve të kërkuar dhe me zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë realizimit të proceseve ndërtimore dhe infrastrukturore në kantier.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (ose ekuivalente), të vlefshme dhe të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO për zërat e mallrave apo të punimeve që merr përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015 konsiderohet teknikisht e argumentuar dhe proporcionalisht e lidhur me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë gërmim dheu, shtresa çakëlli, shtresa graniti, shtresa konglomerati, shtresa stabilizanti, shtresa betoni, mur b/arme, shtresë asfaltbetoni me granil, shtresë binderi me granil dhe shtresë me pllaka guri natyral.

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë procese të ndryshme ndërtimore dhe infrastrukturore që kërkojnë organizim, koordinim dhe kontroll të vazhdueshëm të cilësisë gjatë gjithë fazave të zbatimit të kontratës, duke filluar nga gërmimet dhe realizimi i shtresave infrastrukturore, deri te betonimet, asfaltimet dhe sistemimet përfundimtare.

Certifikata ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë garanton që operatori ekonomik disponon procedura të standardizuara për planifikimin dhe menaxhimin e proceseve të punës, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, monitorimin e zbatimit sipas specifikimeve teknike, menaxhimin e dokumentacionit teknik, kontrollin e proceseve operative dhe të personelit dhe identifikimin dhe korrigjimin e problematikave gjatë realizimit të punimeve.

Për shkak të natyrës infrastrukturore të kontratës dhe proceseve teknike që lidhen me shtresat rrugore, punimet me beton dhe asfalt, realizimi korrekt i punimeve kërkon zbatim të standardeve të kontrollit të cilësisë për të garantuar qëndrueshmërinë e shtresave, parametrat teknikë të betonit dhe asfaltit, saktësinë e realizimit të punimeve, respektimin e projektit dhe specifikimeve teknike dhe përfundimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara.

Gjithashtu, duke qenë se punimet do të realizohen në disa procese paralele dhe brenda një afati 5-mujor, sistemi i menaxhimit të cilësisë është i nevojshëm për koordinimin dhe kontrollin efektiv të aktivitetit ndërtimor në kantier.

Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit të punimeve, profilet e detajeve, vizatimet teknike, si dhe relacioni teknik janë hartuar nga projektuesi në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit dhe zbatimit të punimeve, si dhe me normat profesionale dhe teknike të fushës përkatëse. Këto dokumente pasqyrojnë në mënyrë të plotë, të detajuar dhe të argumentuar të gjitha elementet teknike, funksionale dhe ekonomike të nevojshme për realizimin korrekt dhe në përputhje me standardet e cilësisë të objektit të kontratës, duke garantuar zbatueshmërinë teknike, sigurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e investimit publik. Dokumentacioni teknik është përgatitur në mënyrë të tillë që të mundësojë një kuptim të qartë dhe të njëjtë nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke shmangur paqartësitë, interpretimet subjektive apo kufizimet e pajustificuara të konkurrencës. Për këtë arsye, këto dokumente do t'i bashkëlidhen dokumentacionit të tenderit si pjesë përbërëse dhe thelbësore e tij, ndërsa preventivi është integruar si komponent i pandashëm i dokumentacionit teknik, duke paraqitur në mënyrë të strukturuar, analitike dhe të argumentuar vlerësimin ekonomik të punimeve, materialeve, makinerive dhe shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës.

Specifikimet teknike paraqesin në mënyrë të qartë, të saktë dhe të detajuar minimumin e kërkesave teknike, funksionale dhe cilësore, si dhe tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse të objektit të prokurimit, të cilat garantojnë nivelin e kërkuar të cilësisë, sigurisë, funksionalitetit, jetëgjatësisë dhe qëndrueshmërisë së punimeve. Nëpërmjet tyre sigurohet që çdo produkt, material, pajisje apo shërbim i propozuar nga operatorët ekonomikë të jetë i përshtatshëm për qëllimin e parashikuar, të përmbushë standardet teknike dhe ligjore në fuqi, si dhe të realizojë plotësisht funksionet për të cilat kërkohet. Hartimi i specifikimeve teknike është bërë mbi baza objektive, proporcionale dhe jo diskriminuese, duke respektuar parimet themelore të konkurrencës së lirë, transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e përdorimit efektiv dhe eficient të fondeve publike.

Këto specifikime janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimin publik, konkretisht me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, ku përcaktohet kuptimi dhe përmbajtja e specifikimeve teknike, si dhe nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon detyrimin që specifikimet teknike të sigurojnë akses të barabartë për operatorët ekonomikë dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, hartimi i tyre është mbështetur edhe në nenin 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se specifikimet teknike duhet të formulohen në mënyrë të qartë, të plotë dhe funksionale, duke përshkruar kërkesat teknike dhe standardet që duhet të përmbushë objekti i prokurimit. Në të njëjtën kohë, dokumentacioni teknik është hartuar në respektim të parimeve të përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përkatësisht parimit të transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, barazisë në trajtim dhe garantimit të konkurrencës efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përmes këtij dokumentacioni teknik dhe ekonomik synohet krijimi i një baze të qartë, të unifikuar dhe të verifikueshme për përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave, duke mundësuar krahasueshmëri reale ndërmjet tyre dhe duke garantuar që procedura e prokurimit të zhvillohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe në përputhje me interesin publik. Gjithashtu, dokumentacioni siguron që realizimi i kontratës të kryhet sipas parametrave teknikë të kërkuar, brenda afateve të përcaktuara dhe me standardet e nevojshme të cilësisë, duke minimizuar risqet e mosrealizimit korrekt të punimeve apo të moskonformitetit me kërkesat kontraktore dhe ligjore në fuqi.

NJËSIA E PROKURIMIT